



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense



Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.08/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjin Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ligjin nr. 08/L-156 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 5, paragrafi 1, nen paragrafi 1.3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Rekrutim në FSK, si dhe duke pasur për bazë ofertën e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

**Për përzgjedhjen e tridhjetë (30) kandidatëve për studime në Akademinë
Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në programin 1 vjeçar
“Kurs i Përgatitjes së Oficerit-KPO”**

**I. PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES PËR SHKOLLIM
NË AKADEMINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për rekrutim sipas Rregullores Nr. 07/2023
për Rekrutim në FSK:**

- Të jetë pjesëtar i FSK-së ;
- Të ketë të kryer nivelin e studimeve bachelor (kriter i shtetit pritës);
- Në ditën e mbylljes së konkursit të mos jetë më i vjetër se 25 vjeç e 6 muaj (kriter i shtetit pritës);
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore dhe fizike;
- Te mos ketë masë disiplinore aktive dhe mos të jete në procedure disiplinore;
- Pas mbarimit me sukses të shkollimit, është i obliguar të shërbejë dyfishin e kohës së shkollimit, e cila rregullohet dhe përcaktohet me kontratë.
- Dhënia e informatave të rrejshme kurdo që zbulohet, gjatë procesit të rekrutimit apo gjatë shërbimit në FSK, rezulton me largim nga FSK-ja.

II. PROCEDURAT E TESTIMIT

- Testin fizik;
- Testin e inteligjencës dhe Testin e njohurive të përgjithshme;
- Testi ALCPT (niveli njohurisë së gjuhës angleze);
- Intervistën;
- Testin/ekzaminimin shëndetësor.

Përveç testit ALCPT, të gjitha testet tjera janë diskualifikuese.

E drejta në ankesës:

- Të drejtën e ankesës e ka çdo kandidatë pas marrjes së rezultateve të çdo faze të testimit përkatës.
- Rezultatet publikohet në Ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së dhe kandidatët e eliminuar kanë të drejtë ankese brenda afatit dy (2)- ditor.
- Afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të rezultatit.
- Ankesa dorëzohet përmes e-mail adresës së Rekrutimit.
- E drejta e ankesës aplikohet për të gjitha llojet e testimeve.

Kushtet tjera:

- Njohja e gjuhës angleze, në të shkruar dhe komunikim, do të jetë përparësi;
- Përzgjedhja për kadetë është e kushtëzuar me kalimin e suksesshëm të verifikimit të sigurisë;
- Pjesëtarët e FSK-së të cilët përzgjidhen për studime marrin statusin e kadetit dhe realizojnë pagën e kadetit të FSK-së deri në përfundimin e studimeve;
- Kandidatet e përzgjedhur për kadet, do të nënshkruajnë kontratën e shkollimit me FSK-në me të cilën përcaktohen obligimet që ata do të marrin si kadetë të FSK-së, si mbajtja e standardeve të larta të shkollimit akademik, gjendjes fizike, sjelljes dhe disiplinës. Mos përmbushja e obligimeve të parapara me kontratë do të rezultojë me humbjen e statusit të kadetit.

Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, kandidatët do të informohen për performancën e tyre. Lista finalë e të përzgjedhurve do të bazohet në performancën e treguar nga secili kandidat, bazuar në pikët e akumuluar nga secili test. Për të pasur sukses, kandidatët inkurajohen të përgatiten me përkushtim për këtë proces.

III.AFATI I KONKURRIMIT:

Konkursi është i hapur prej 03.07.2026 deri më 16.07.2026, ora 23:59.

Si të aplikoni;

Aplikimi dhe njoftimi për kadet të FSK-së është online në adresën <https://rekrutimi.fsk-rks.org> si dhe njoftimin për shpalljen e konkursit mund ta shikoni edhe në web faqen e MM-së, <https://mod.rks-gov.net> ku gjendet shpallja e konkursit. Kandidatët plotësojnë formularin e aplikimit online <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> dhe bashkëngjisin të gjitha dokumentet tjera të kërkuara nga ky formular. Kandidatet kanë të drejtë të aplikojnë deri në ditën e fundit të përmbylljes së konkursit. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. tel. 038-555584-5690 dhe 038-555584-5691 nga ora 09:00 deri 15:00.

Ministria e Mbrojtjes ofron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikacionet e tyre, pa dallim nga përkatësie etnike apo gjinore.